

TRAJNIM PRAKTIK PËR NXËNËSIT NGA ARSIMI I MESËM PROFESIONAL

– PËRFITIME MË TË MËDHA SE SHPENZIME

(PËRMBLEDHJE E SHKURTË E POLITIKAVE)



Ky dokument është përmbledhje e gjetjeve nga hulumtimi që synon përcaktimin e qëndrimeve të punëdhënësve¹ për përfitimet e përfshirjes aktive në procesin e realizimit të trajnimit praktik për nxënësit nga arsimi i mesëm profesional.

Punëdhënësit identifikojnë shpenzimet dhe përfitimet e mëposhtme:

Shpenzimet	Përfitimet
<ul style="list-style-type: none">➔ Mentori te punëdhënësi (orë pune)➔ Trajnimi i mentorëve➔ Pajisje për trajnim, mjete dhe materiale mësimore➔ Kompensim për nxënësit➔ Sigurimi i nxënësve➔ Transporti i nxënësve	<ul style="list-style-type: none">➔ Punë produktive e nxënësve➔ Kursime gjatë kërkimit të punëtorëve➔ Rrezik i zvogëluar nga punësimi i personelit joadekuat➔ Shkathtësi specifike e nxënësit për vendin e punës - punëdhënës➔ Promovimi i punëdhënësit dhe njohje e përgjegjësisë sociale➔ Ndikimi pozitiv në ambientin e kompanisë➔ Lidhje më të forta me sektorin publik

Ky punim bazohet në kërkime që përfshinin parametra që vlerësojnë përfitimet e trajnimit praktik, përfshirë: njohuritë dhe aftësitë e nxënësve, produktivitetin e nxënësit dhe ndikimin në punonjësit e tjerë, kursimet e mundshme të punëdhënësit dhe efektet afatgjata të përfshirjes në këto procese.



Gjetjet kryesore	Korniza për veprim
<ul style="list-style-type: none">➔ Përfitimet e trajnimit të nxënësve për punëdhënësit janë më të mëdha ose të barabarta me shpenzimet.➔ Pas përfshirjes së nxënësve në trajnimin praktik, nuk krijohen shpenzime shtesë të konsiderueshme për punëdhënësit.➔ Nxënësit kontribuojnë në punën produktive të punëdhënësit; rreziku i gabimit është në një nivel të pranueshëm.➔ Shumica e punëdhënësve kanë bashkëpunim të fortë me shkollat e mesme profesionale, mësuesit dhe nxënësit.	<ul style="list-style-type: none">➔ Nevojitet një strategji e qartë për të përfshirë nxënësit te punëdhënësit dhe bashkëpunim më të madh midis shkollave profesionale dhe punëdhënësve.➔ Përshtatje dhe përmirësim të vazhdueshëm të programit mësimor, udhëzime dhe materiale trajnuese.➔ Menaxhim më i mirë dhe proces i përmirësuar arsimor në shkollat profesionale.➔ Fillim të hershëm dhe vazhdimësi në trajnimin praktik me punëdhënësit.➔ Rritja e ndërgjegjësimit midis palëve të ndryshme të interesit në lidhje me përfitimet praktike të trajnimit.➔ Stimujt financiarë për punëdhënësit, dhe mbi të gjitha, për materialet dhe disa kompensime për nxënësit.➔ Vendimarrje e përbashkët dhe përgjegjësi për kryerjen e trajnimit praktik.

1. Në këtë dokument termat punëdhënës dhe kompani përdoren si sinonime.

KONTEKST



METODOLOGJIA

Trajnimi praktik me një punëdhënës për nxënësit e shkollave të mesme është një pjesë e detyrueshme e procesit të arsimit të rinjve në shkollat profesionale.

Sipas Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (neni 13), punëdhënësit mund të sigurojnë trajnim praktik për nxënësit, nëse ata plotësojnë kërkesat për hapësirë, pajisje dhe personel të duhur të përshkruara nga odat përkatëse. Odat verifikojnë përmbushjen e kushteve nga punëdhënësit.

Ekzistojnë 75 shkolla të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut që aktualisht ofrojnë arsim dhe aftësim profesional për rreth 42,000 nxënës. Në vitin akademik 2021/22, më shumë se 25,000 nxënës duhet të kryejnë trajnim praktik te punëdhënësit.

Bashkëpunimi i shkollave të mesme profesionale me punëdhënësit ka një ndikim të rëndësishëm në procesin arsimor dhe tregun e punës dhe kontribuon në:

- proces arsimor më efikas dhe financiarisht të qëndrueshëm
- nxënës që fitojnë aftësi të nevojshme për ekonominë
- produktivitet më të lartë të ndërmarrjeve, si rezultat i një fuqie punëtore më e kualifikuar
- shkallë e ulur e papunësisë, në saje të përvetësimit të aftësive të rëndësishme për tregun e punës.

Hulumtimi u krye në kuadër të projektit të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) - Arsim për Punësim në Maqedoninë e Veriut (E4E @ mk).

Projekti E4E@mk në partneritet me Fondacionin Evropian të Trajnimit (ETF), mbështet Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në krijimin e modeleve të përmirësuara të financimit për arsimin profesional dhe trajnimin (APT), me një theks në trajnim praktik në kompani.

Objektivat e hulumtimit ishin si vijon:

- të përcaktohen shpenzimet dhe përfitimet e kompanive në ofrimin e trajnimeve praktike për nxënësit e shkollave të mesme profesionale; dhe
- të sigurohen informacione mbi krijimin e politikave dhe masave të përshtatshme për të përmirësuar procesin e trajnimit praktik të nxënësve në arsimin e mesëm profesional në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me përfshirje më të madhe të kompanive.



Në periudhën 19 maj - 19 qershor 2020, u mbledhën të dhënat nga kompanitë e përfshira në forma të ndryshme të trajnimit praktik të nxënësve.

Metodat e hulumtimit të aplikuar ishin si vijon:

- anketë me një grup të zgjedhur të kompanive; dhe
- intervista të strukturuar hollësisht me një pjesë të kompanive të anketuara.

Nga 75 kompani të afruara nga studiuesit, në hulumtim morën pjesë 30 kompani me madhësi të ndryshme nga 10 sektorë të ndryshëm ekonomikë.

GJETJET




KOMPANITË MARRIN PJESË NË ORGANIZIMIN E PROCESIT TË TRAJNIMIT PRAKTIK

“Ne i duam nxënësit, nuk kursejmë dhe punojmë me ta me kënaqësi”.

“Ne e dimë që në shkollë nxënësit nuk marrin të gjitha njohuritë e nevojshme dhe me kënaqësi i përfshijmë ata në aktivitete praktike tek ne.”.


- ➔ **Pjesa më e madhe** e të anketuarve kanë bashkëpunim të fortë me shkollën, mësuesit dhe nxënësit.
- ➔ **Afër gjysma** e të anketuarve deklaruan se i pranojnë të gjithë nxënësit që do tu ofrojë shkolla, pa përdorur kriterë të tjera shtesë të përzgjedhjes. Sidoqoftë, disa kryen intervista të shkurtra me nxënësit, kishin kërkuar referime nga arsimtarët, ose kanë krijuar kontakte personale për të siguruar nxënës më të mirë për trajnim praktik.
- ➔ **Gjysma** nga të anketuarit konsiderojnë se trajnimi praktik është i rëndësishëm dhe duhet të organizohet në periudha më të gjata gjatë vitit. Kjo do të mundësojë prani të rregullt dhe më aktive të nxënësve në kompanitë.
- ➔ **Rreth tre të katërtat** e të anketuarve deklaruan se ata kanë ndikim të caktuar në programin mësimor që realizohet në kompaninë e tyre.
- ➔ **Gati dy të tretat** e të anketuarve shpjeguan se zgjedhja e aktiviteteve dhe detyrave të punës së nxënësve gjatë trajnimit praktik bëhet nga mentori/punonjësi në kompani, ose mentori në bashkëpunim me arsimtarin e shkollës.
- ➔ Nxënësit janë të përgatitur në shkollë, por jo sa duhet me aftësi dhe njohuri specifike para se të bashkohen me kompaninë.



PËRFITIME TË NDRYSHME PËR KOMPANITË



Përreth dy të tretat nga kompanitë theksojnë se përfitimet e kompanive nga trajnimi i nxënësve janë më të mëdha ose të barabarta me shpenzimet.




„Është e vështirë të jepet një përgjigje nëse përfitimet i tejkalojnë shpenzimet, por mendoj se është diku 50% - 50%.“

„Nëse procesi funksionon si duhet, përfitimet do të jenë shumë më të mëdha.“

- ➔ Kompanitë i identifikojnë ato lehtësisht përfitimet afatgjata nga pranimi i nxënësve në trajnimin praktik. Këto përfshijnë: lehtësimin e procedurave dhe uljen e shpenzimeve të punësimeve të reja, punësimin e njerëzve me aftësitë e duhura, ndikimin pozitiv të nxënësve në klimën e kompanisë dhe përmirësimin e besnikërisë së punonjësve.
- ➔ 61% e të anketuarve deklarojnë se nxënësit kanë një efekt pozitiv në rritjen e angazhimit dhe punës së punonjësve; 58% deklarojnë që nxënësit kontribuojnë në produktivitetin e ndërmarrjes (punë e pakualifikuar ose gjysmë e aftë); 42% deklarojnë se nxënësit ndikojnë në përmirësimin e aftësive të shumicës së punonjësve.

- ➔ Përfitim i rëndësishëm për gati dy të tretat nga kompanitë është ndihma e dhënë nga nxënësit për mentorin dhe punonjësit në kryerjen e proceseve të thjeshta të punës, të tilla si mirëmbajtja e vendit të punës, kujdesi për materialet e punës, makineritë dhe mjetet, etj.
- ➔ Nxënësit kontribuojnë, por shume pak, duke prezantuar njohuri të reja, duke përdorur mënyra të reja të punës, si dhe duke përdorur teknologji të reja

Çfarë kontribuojnë nxënësit në vendin e punës?



Si ndikon pranimi i nxënësve në kompani?

„Ne lëmë një imazh pozitiv te klientët dhe ata janë më të kënaqur.“

„Efikasiteti ynë i punës rritet kur punojmë me nxënësit“.

„Ndikimi pozitiv mbi punonjësit e tjerë, rrit aftësinë konkurruese të tyre dhe ndikon në punën e përgjithshme.“



KA GJITHASHTU SHPENZIME PËR PËRFSHIRJE NË TRAJNIMIN PRAKTIK


- ➔ Një nga kostot e mundshme që duhet të përcaktohet nga punëdhënësit është sigurimi i kompensimit për nxënësit. Më shumë se dy të tretat e punëdhënësve paguajnë **kompensim për nxënësit**, zakonisht jo më të lartë se 20% të pagës mesatare për punën përkatëse. Ata konsiderojnë se alokimi i fondeve për këtë qëllim **nuk është ndonjë barrë financiare**.
- ➔ Sipas mendimit të **gjysmës** së të anketuarve, kompensimi për nxënësit duhet të sigurohet nga kompania ose shkolla profesionale, së bashku me kompaninë. Të tjerët besojnë se kompensimi duhet të sigurohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës ose shkolla profesionale.
- ➔ Pranimi i nxënësve **nuk pëson shpenzime shtesë të konsiderueshme** për kompaninë. Këto kosto përfshijnë: mbështetjen dhe monitorim/mbikëqyrje të punës së nxënësve, sigurimin e mjeteve dhe materialeve për punë, kostot administrative, si dhe kostot që lidhen me shëndetin dhe sigurinë në punë, etj.
- ➔ Për **gati gjysmat** e kompanive, shpenzimet e lidhura me gabimet e mundshme të bëra nga nxënësit gjatë trajnimit praktik janë një rrezik i pranueshëm.

„Mund të sigurojmë fonde, tashmë i kemi ato në buxhet dhe mendojmë se çdo kompani duhet të sigurojë kompensim të paktën për ushqimin, transport dhe shpenzime të tjera.“

„Në mënyrë që të tërheqim fëmijët, duhet t'i paguajmë, sepse shumica e tyre janë në një situatë të vështirë financiare.“

„Ndonjëherë është vështirë të sigurojmë kompensim. Të paktën në fillim / për vitet e para të shkollimit është mirë që shteti ose shkolla të na ndihmojë që të mundemi ta bëjmë atë“

Sa duhet të jetë kompensimi për nxënësin?





REKOMANDIMET NGA INTERVISTAT ME KOMPANITË:

- ➔ Ekziston nevoja për një fleksibilitet, besim dhe liri më të madhe të shkollave profesionale dhe kompanive në planifikimin, organizimin dhe kryerjen e trajnimit praktik (për shembull, numri i orëve / ditëve / periudhave i përcaktuar në mënyrë rigorozë dhe përmbajtja e trajnimit praktik shpesh nuk përshtaten me sektorët ekonomikë dhe kompanitë).
- ➔ Mbështetje institucionale për ndërmarrjet dhe shkollat profesionale për vendime të përbashkëta dhe përgjegjësi për zbatimin e trajnimit praktik.
- ➔ Përmirësimi i procesit arsimor dhe sigurimi i cilësisë në shkollat profesionale, për sa i përket njohurive, aftësive dhe sjelljes shoqërore të nxënësve para përfshirjes së tyre në trajnimin praktik.
- ➔ Përshtatja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i programit mësimor, materialeve mësimore dhe burimeve të trajnimit, me përfshirjen e plotë të punëdhënësve.
- ➔ Menaxhim më i mirë i shkollave profesionale duke përfshirë personat të cilët do të jenë përgjegjës për krijimin dhe promovimin e bashkëpunimit midis shkollës profesionale dhe kompanive.
- ➔ Klasa të pajisura më mirë në shkollat profesionale, në përputhje me nevojat e profesioneve që ata ofrojnë.
- ➔ Fillimi i hershëm i trajnimit praktik në kompani dhe sigurimi i vazhdimësisë disa ditë në javë.
- ➔ Procesi për zgjedhjen e nxënësve që do të ndjekin trajnim praktik në kompani të caktuar bazuar në kriteret e përcaktuara. Kjo do të rrisë aftësinë konkurruese dhe nivelin e konkurrencës midis nxënësve, si dhe përfshirjen e nxënësve me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për trajnimin praktik në kompani.
- ➔ Stimuj financiar për kompanitë për të siguruar materiale trajnimi dhe disa kompensime për nxënësit, të paktën fillimisht në një kohë kur produktiviteti i tyre është shumë i ulët.
- ➔ Mbështetje nga qeveria qendrore dhe lokale në promovimin e përfitimeve të trajnimit praktik për shoqërinë/prindërit/nxënësit.

Hulumtuesit:

Katerina Shapkova Koçevska

Borçe Trenovski

Mbështetje profesionale:

Anica Aleksova, Eksperte e Politikave dhe Menaxhimit në E4E@mk

Stefan Tomas, Specialist i Politikave dhe Sistemeve të Arsimit Profesional dhe Trajnimit në Fondacionin Evropian për Trajnim

Raporti i plotë i hulumtimit është në dispozicion në

<https://www.e4e.mk/proektni-publikacii/>